



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 482/22

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 06.04.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Drejtorëve të Drejtorive dhe zyrtarëve tjerë në pozita udhëheqëse në administratën e komunës iu ndalohet pranimi në punë praktike i praktikantëve, pa miratimin e Kryetarit të Komunës.
2. Ndaj shkelësve të kësaj Urdhërese do të merren masa ligjore.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorëve të Drejtorive
- Zyrës së Personelit
- Arkivit të Sekretarisë

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02/Nr./Br 544/22

Nr. i fq./Br. sf _____

Data: / Datum 20.04.2022

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere lejohet subvencionimi në shkallë prej 50%, ose deri në 75.00 € për një person, për shpenzimet e përfundimit tre mujorë të trajnimit në SPEEEX Edukation në Vushtrri ose ndonjë kompanie tjetër e licencuar e cila ushtron veprimtari të njëjtë në Vushtrri, në fusha të cekura si nën pikën 2 të këtij vendimi. Ky subvencionim bëhet për katërqind (400) pjesëmarrës në trajnim të Komunës së Vushtrrisë, të cilët përfundojnë me sukses trajnimin.
2. Ndjekësit e këtij trajnimi do të jenë të përgatitur në këto module:
 - Modulin e të mësuarit të gjuhës Gjermane apo Frënge
 - Modulin e aftësive të komunikimit
 - Modulin e aftësive teknike
 - Modulin e mësimit praktik
3. Pagesa e mjeteve të bëhet në llogari të secilit që ka përfunduar me sukses trajnimin tre mujorë përkatësisht është pajisur me certifikatë nga SPEEEX Edukation në Vushtrri apo kompani tjetër legale në Vushtrri e cila ka kryer trajnime të fushave të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi dhe e cila ofron ofertë pune pas përfundimit të trajnimit. Pagesa mund të bëhet edhe në emër të njërit prind nëse përfituesi i këtyre mjeteve është i moshës jo madhore apo përfaqësuesit ligjorë.
4. Me rastin e aplikimit për këtë subvencionim duhet të dorëzohen në zyrën pritëse: Kërkesa e adresuar për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Certifikata për kryerje të trajnimit si dhe Certifikata e vendbanimit me të cilën dëshmohet se është banor rezident i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 496/21, datë 28.04.2021.
7. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet nga data 01 janar 2022 deri në përmbushjen e numrit të përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë

